



Nr. 414 Prot

Tiranë 24 /07/2023

URDHËR

Nr. 113, Datë 24 / 07 2023

PËR KRIJIMIN E GRUPIT AD-HOC TË PUNËS, PËR MBËSHTETJEN E AVOKATIT TË POPULLIT NË USHTRIMIN E KOMPETENCAVE LIGJORE, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR, SI DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË, NGA RADHËT E AVOKATËVE DHE SHOQËRISË CIVILE

Mbështetur në nenin 2 të ligjit nr. 8454/1999 "Për Avokatin e Popullit", nenet 21-27, 54-58, 117-125, 129 dhe 152-156 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë", si dhe nenin 28 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Krijimin e Grupit Ad-Hoc të Punës për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile.
2. Grupi Ad-Hoc i Punës, do të ketë në përbërje:
 - 2.1. Z. Fatbardh Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm - Kryetar
 - 2.2. Z. Enio Haxhimihali, Ndhimëskomisioner - Zv/kryetar
 - 2.3. Zj. Dejana Burgija, Ndhimëskomisioner - Anëtar
 - 2.4. Zj. Kejsi Rizo, Ndhimëskomisioner - Anëtar
 - 2.5. Zj. Antoneta Skënderi përgjegjëse e Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve dhe/ose z. Aldo Bali, specialist i Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve - Anëtarë
 - 2.6. Zj. Ina Goxhaj dhe/ose zj. Merita Hysenaj, specialiste protokolli - Anëtarë

3. Grupi Ad-Hoc i Punës do të përgatisë dhe ofrojë asistencën e nevojshme Avokatit të Popullit, për detyrat në vijim:
 - a. Hartimi i një projektregullore për procedurat që do të ndiqen nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile (brenda datës 10 gusht 2023).
Kjo projektregullore, pasi të jetë aprovuar nga Avokati i Popullit, do i dërgohet paraprakisht për mendim të gjithë anëtarëve të Komisionit të Pavarur Ad Hoc dhe do të shqyrtohet në mbledhjen e parë të këtij Komisioni.
 - b. Hartimi i një rregulloreje për procedurat e funksionimit të vetë Grupit Ad-hoc (brenda datës 03 gusht 2023), e cila do të miratohet nga Avokati i Popullit.
4. Anëtarët e parashikuar në pikat 2.1 – 2.4 të Grupit Ad-Hoc, pas përfundimit të afatit të shprehjes së interesit nga kandidatët e interesuar (si në rastin e avokatëve, ashtu edhe për anëtarët e shoqërisë civile), brenda afateve ligjore:
 - 4.1.do të verifikojnë nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i plotë dhe
 - 4.2.do të vendosin në se do i kërkojnë kandidatëve të bëjnë plotësimin e dokumentacionit, apo paraqitjen e dokumenteve shtesë.
5. Për komunikimet me kandidatët do të përdoret adresa e e-mailit info@avokatipopullit.gov.al, e cila do të kontrollohet nga nëpunësi i protokollit. Mesazhet që do i dërgohen kandidatëve do të aprovohen paraprakisht nga Grupi Ad-Hoc.
6. Për komunikimet me publikun në lidhje me këtë proces, në faqen web të institucionit do të çelet një rubrikë e veçantë. Njoftimet hartohen nga anëtarët e parashikuar në pikat 2.1 – 2.4 të Grupit Ad-Hoc dhe pas aprovimit nga titullari i institucionit, publikohen nga: Sektori i IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve dhe këshilltari për mediat.
7. Grupi Ad-Hoc i Punës i krijuar me këtë Urdhër, do të shërbejë edhe si Sekretariat teknik për Komisionin e Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile, deri në përfundim të të gjithë procesit.
Detyrat specifike të Grupit ad-hoc, do të përcaktohen në rregulloren që do të miratohet në zbatim të parashikimit të pikës 3b të këtij Urdhëri.
8. Sektori i IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve të njoftojë të gjithë nëpunësit që u lindin detyrime nga ky Urdhër dhe gjithashtu ta publikojë atë në faqen zyrtare web të institucionit.
9. Ndjekja e zbatimit të këtij Urdhëri, do të bëhet nga Avokati i Popullit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

Erinda Ballanca

